



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:043838

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05684558

KPPP.nr. 1833/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare – Klinika e Kirurgjisë, me seli në Prishtinë, me bazë përmbartimi sipas titullit ekzekutiv, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seancës, me datë 14.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare – Klinika e Kirurgjisë, me seli në Prishtinë.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Aktvendimin E.nr. 1315/07, të datës 16.06.2020, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit për pagesën e detyrimit sipas titullit ekzekutiv në lartësi prej EUR

6,000.00. Ndërsa, e njëjta gjykatë me aktvendimin E.nr. 1315/07, të datës 01.02.2023 është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si gjykatë kompetente për të proceduar në këtë çështje përmbartimore.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbartimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbartimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbartimit sipas aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbartimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së. Andaj, në mungesë të mjetit juridik, në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbartimore.

Duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përbarimore është caktimi dhe zbatimi i aktvendimit mbi lejimin e përbarimit nga gjykata si organ përbarues, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1833/23, datë 14.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.